



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor, 2008) dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **dytë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **11.03.2015** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.

Për këtë mbledhje **p r o p o z o n** këtë

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;
2. Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ;
3. Propozimrregullorja për kriteret e planifikimit të kushteve të propozuara ndërtimore;
4. Propozimvendim për themelimin e Komitetit konsultativ për persona me nevoja të veçanta;
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit Olimpik;
6. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal " Gërmia" në kategorinë peizazh i mbrojtur;
7. Propozimi për ndërrimin e destinimit të tokës nga ajo bujqësore, në tokë ndërtimore;
8. Propozimvendimi për lëvizjen e trasesë së rrugës në mes të bllokut "G" dhe "D" në kuadër të Planit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - zona Qendër", afër Pallatit të Drejtësisë;
9. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit mësimor 2014/2015;
10. Informatë për ndarjen e bursave për vitin akademik 2014-2015;
11. Informatë për personelin arsimor në komunë;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 006-44917, më 24.02.2015

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

Vërejtje: *Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. Kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.*